FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 99 — 10 gusht — 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 7706 datë 19.7.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare……	5419
Dekret nr. 7715 datë 20.7.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare……	5419
Dekret nr. 7724 datë 20.7.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare ……	5420
Dekret nr. 7725 datë 20.7.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare ……	5420
Udhëzim i MMPAU nr. 1, datë 2.7.2012	Për përcaktimin e kritereve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik……	5421
Udhëzim i MPPT nr. 10, datë 9.7.2012	Mbi rregullat në transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe të bagazheve……	5425
Udhëzim i MASH nr. 10, datë 10.7.2012	Për masat për zhvillimin e provimeve të sesionit të dytë të provimeve të lirimit dhe të maturës shtetërore 2012….	5438
Udhëzim i MASH nr. 12, datë 11.7.2012	Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, viti akademik 2012-2013…….	5440
Udhëzim i MPPT nr. 12, datë 19.7.2012	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 749, datë 28.12.1999 “Për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme”……	5445

Urdhër i MPPT nr. 77, datë 17.7.2012	Për miratimin e rregullores mbi kriteret e përbashkëta për përcaktimin e një liste të BE-së për transportuesit ajrorë, të cilëve u ndalohet operimi brenda BE-së dhe ZPAE-së, si dhe mbi informimin e pasagjerëve për identitetin e këtyre transportuesve ajrorë ……	5447
Urdhër i MASH nr. 287, datë 6.7.2012	Për miratimin e formës së studimit, me kohë të pjesshme të programeve të studimeve të ciklit të parë "Bachelor" dhe të ciklit të dytë "Master profesional" të universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës……	5453

DEKRET
Nr. 7706, datë 19.7.2012

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Merita Ismet Röck (Beci)
2. Andro Agron Hoxha
3. Bledar Haxhi Spahija
4. Greta Ali Gritsch (Salihi)
5. Bernarda Nexhip Wilden (Balli)
6. Diana Avdulla Cani (Thaci)
7. Enkelejd Adrian Lluca
8. Frosa Hysni Koçi (Cangtari)
9. Denzel Agron Koçi
10. Kath Agron Koçi
11. Artur Bajram Shehu
12. Jessica Artur Shehu
13. Orjona Hyqmet Shehu
14. Ardiana Hasim Gerdeci
15. Julian (Juljan) Nikolla Kule
16. Gëzim Pelivan Ferko
17. Majlinda Mefail Vila
18. Marlon Gëzim Vila
19. Franziska Gëzim Vila
20. Xhordano Latif Arbana
21. Megi Halit Patushi
22. Arjana Shpetim Emiri
23. Evis Ilir Emiri
24. Laureta Lazer Elezi (Triepshi)
25. Merita Rexhep Mavraj (Iljazi)
26. Valbona Halit Zavalani
27. Elvira Shaban Kadrija
28. Agron Shaban Matoshi
29. Albana Pasho Sade
30. Jonas Alfred Mane
31. Adrian Kadri Ibranji
32. Eglantin Xhevit Baraj
33. Renato Mhill Tusha
34. Anila Mhill Tusha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7715, datë 20.7.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Sokol Nevzat Dauti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7724, datë 20.7.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Meshar Rustem Kamberi
2. Ardijan Rustem Kamberi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7725, datë 20.7.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Furtuna Mhill Velaj
2. Advije Qazim Veliu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

UDHËZIM
Nr. 1, datë 2.7.2012

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT DHE PROCEDURËN E DHËNIES NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9385 datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të nenit 17 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar.

UDHËZOJ:

1. Sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor publik jepen në përdorim me kontratë qiraje nëpërmjet procedurës së konkurrimit publik.

2. Sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor që jepen në përdorim sipas përcaktimit të pikës 1 janë:

- sipërfaqe me pyje;
- sipërfaqe me bimësi pyjore;
- sipërfaqe inproduktive;
- sipërfaqe kullosore/livadh; si dhe
- infrastruktura përkatëse.

3. DSHP-të vlerësojnë dhe propozojnë në ministri, sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor, si dhe infrastrukturën përkatëse që mund të jepen në përdorim. Në vlerësimin e fondit pyjor e kullosor që propozohen të jepen në përdorim, DSHP-të mbajnë parasysh që:

a) sipërfaqet mund të jepen vetëm për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 19 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar dhe në nenin 17 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar;

b) veprimtaritë që do të ushtrohen në këto sipërfaqe, të jenë në harmoni me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe në përputhje me planet e tyre të mbarështimit;

c) afati i dhënies në përdorim të jetë në përputhje me afatin e planit 10-vjeçar të mbarështimit. Kontrata, pavarësisht kohëzgjatjes së saj, rinovohet çdo vit nga DSHP-ja përkatëse pasi verifikohet zbatimi i kushteve kontraktuale;

d) projektet e veprimtaritë që do të ushtrohen duhet;

- të sjellin përmirësime të dukshme në mbarështimin e florës dhe faunës që ndodhen në këto sipërfaqe;

- të realizojnë investime që përmirësojnë tregues biologjikë dhe të infrastrukturës së zonës;

- të mos cenojnë vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike;

- të jenë në përputhje me investimet publike që janë planifikuar të bëhen në zonë në 10 vitet e ardhshme.

4. Për çdo sipërfaqe që propozohet të jepet në përdorim, DSHP-ja sugjeron edhe llojin e veprimtarisë që mund të ushtrohet në të dhe përgatit studimin, i cili përmban:

a) sipërfaqen e fondit pyjor ose kullosor e shprehur në (ha), me kufij të përcaktuar qartë në harta, të shkallës 1:10000 ose 1:25000 (koordinatat gjeografike, metrike);

b) treguesit identifikues (kadastralë) të ngastrave ose nën/ngastrave;

c) karakteristikat silvikulturale të grumbullit pyjor;

d) treguesit tekniko-ekonomikë për kullotat dhe livadhet;

e) treguesit e vlerës për çdo njësi kadastre të pyjeve dhe kullotave që parashikohet të jepen me qira;

f) vlerën dysheme të qirasë për ha/vit, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;

g) sipërfaqja e propozuar për t'u dhënë në përdorim të mos jetë objekt pretendimi për rikthimin e pronës ish-pronarëve;

h) sipërfaqja e propozuar të mos jetë objekt tjetërsimi në një afat 10-vjeçar në rastet kur në to janë planifikuar investime publike;

i) sipërfaqja që propozohet të jepet në përdorim për mbarështim flore të mos jetë më e vogël se madhësia limit e një nën/ngastre (0,5 ha).

5. Kur sipërfaqe të fondit pyjor propozohen që të ushtrohen veprimtari pushimi, DSHP-të përgatisin studimet sipas kërkesave të pikës 4 të këtij udhëzimi dhe në muajin janar të fillimit të vitit kalendarik i paraqesin këto studime në ministri për të marrë miratim për vazhdimin e procedurave të konkurrimit për dhënie në përdorim me kontratë qiraje, për një periudhë sezonale jo më shumë se 3 deri 4 muaj.

6. Pas shqyrtimit të propozimeve të DSHP-ve, drejtoria përkatëse teknike në ministri, i përcjell ato te ministri për miratim dhe pas miratimit, njoftohet drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor dhe komisioni i vlerësimit të kërkesave i ngritur me urdhër të ministrit për të vazhduar procedurat e konkurrimit publik.

7. Subjektet publike ose private që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në sipërfaqet e fondit pyjor ose kullosor, paraqesin kërkesën në formën e propozimit të pakërkuar. Kjo sipërfaqe do të përdoret vetëm për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 19 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar dhe në nenin 17 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar. Propozimi duhet të plotësojë kërkesat e këtij udhëzimi.

8. Për administrimin e kërkesave në këto raste, DSHP-ja kryen këto detyra:

a) përgatit raportin teknik për sipërfaqen e kërkuar;

b) dërgon në ministri për shqyrtim dhe miratim kërkesën së bashku me raportin teknik;

c) pas miratimit nga ministri, MMPAU-ja shpall sipërfaqen për konkurrim publik dhe komisioni i vlerësimit të kërkesave, pasi shpall fituesin, njofton zyrtarisht DSHP-të përkatëse për lidhjen e kontratës.

9. Shqyrtimi i kërkesave për dhënien me qira të fondit pyjor dhe kullosor, bëhet nga MMPAU-ja.

10. Konkurrimi publik për dhënien me qira të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor bëhet:

a) nëpërmjet shpalljes së njoftimit për konkurrim publik për dhënien me qira të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor.

b) njoftimi bëhet nëpërmjet Buletinit të Prokurimit Publik, i cili përmban të dhënat për sipërfaqen, vendin dhe adresën ku mund të tërheqin dokumentacionet e nevojshme dhe vendin, datën e orën e paraqitjes së dokumentacionit.

c) data e konkurrimit të jetë jo më parë se 15 ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

11. Subjektet që marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e kompanisë;

b) ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;

c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar dhe që trajton të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;

d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;

e) të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;

f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;

g) nivelin e punësimit në veprimtari;

h) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;

i) adresën subjektit, si dhe tel. dhe faks.

12. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;

b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale, të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;

c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj MMPAU-së.

13. Për vlerësimin e kërkesave të paraqitura, në MMPAU, titullari urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit. Urdhri për ngritjen e këtij komisioni përmban gjithashtu dhe:

a) të dhënat e zonës: emërtimi, sipërfaqja, koordinatat, qëllimi i përdorimit, çmimi dysheme, afati;

b) veprimtarinë që mund të ushtrohet në ketë sipërfaqe;

c) pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, të përcaktuara sipas pikës 14 të këtij udhëzimi;

d) vendin, datën dhe orën, ku paraqiten dokumentet;

e) përbërjen e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, i cili në çdo rast përbëhet nga jo më pak se pesë anëtarë, specialistë të drejtorisë;

f) dokumentacionin, që do të paraqitet në konkurrim nga konkurrentët.

14. Komisioni i vlerësimit ka këto detyra:

a) hap në prani të konkurrentëve zarfet me dokumentacionin e paraqitur prej tyre, duke bërë të njohura të dhënat kryesore për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, ai skualifikon subjektin konkurrues, në prani të tij;

b) harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruan pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkakun, konkurrentët e kualifikuar dhe listën e dokumenteve të paraqitura prej tyre;

c) brenda 10 ditëve bën shqyrtimin e ofertave të paraqitura dhe vlerëson me pikë çdo element konkurrimi;

d) në përfundim, rendit konkurruesit në bazë të pikëve të përfituara;

e) Paraqet, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c” të kësaj pike, te drejtori, një informacion për zhvillimin e konkurrimit, së bashku me procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit dhe listën e konkurruesve, të renditur sipas pikëve të fituara.

15. Vlerësimi i ofertës mbështetet në grumbullimin e pikëve si më poshtë:

a) projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet që përmban planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartë topografike të digjitalizuar dhe të gjeoreferuar me shkallë 1:10000 ose 1:25000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit……. 20 pikë;

b) planbiznesi dhe investimet që do të bëhen……. 15 pikë;

c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes……. 25 pikë;

d) nivelin e punësimit në veprimtari……. 5 pikë;

e) masën e qirasë për ha/vit……. 35 pikë.

16. Komisioni vendos për subjektin fitues të konkurrimit. Njofton për shpalljen e fituesit, në këndin e njoftimeve të MMPAU-së ose DSHP-së.

17. Subjektet konkurruese, brenda 5 ditëve nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimimit tek titullari, i cili, brenda 10 ditëve, i përgjigjet ankuesit me shkrim.

18. Pas përfundimit të procedurave të mësipërme, me fituesin lidhet brenda 10 ditëve kontrata e qirasë tip e miratuar nga ministri. Nëse fituesi nuk e lidh kontratën brenda këtij afati, kontrata lidhet me subjektin që është renditur i dyti në listën e konkurrimit.

19. Sipërfaqja dorëzohet me procesverbal dhe në përfundim të përdorimit merret në dorëzim nga DSHP-ja po me procesverbal.

20. Kontrata e qirasë, veç të tjerash, përmban detyrimin e qiramarrësit:

a) për të zbatuar projektin, planin e investimeve dhe të rehabilitimit të sipërfaqes së përdorur;

b) për të ruajtur mjedisin rrethues nga ndotjet dhe dëmtimet që mund të shkaktojë veprimtaria e tij;

c) për të siguruar mbrojtjen nga zjarri dhe angazhimin në shuarjen e tij;

d) për të informuar me shkrim në MMPAU ose DSHP për ecurinë e veprimtarisë e problemet që dalin;

21. Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitet pasardhëse.

22. Të ardhurat e siguruara nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore e kullosore administrohen sipas shkronjës “b” të pikës 1 të vendimit nr. 432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.

23. Përjashtohen nga konkurrimi pavarësisht madhësisë së sipërfaqes, dhënia me qira e sipërfaqeve dhe e infrastrukturës ndihmëse kur subjektet juridike janë të pajisura me leje përkatëse për veprimtaritë e mëposhtme: që janë pajisur me lejet, licencat dhe dokumentet e nevojshme në plotësim të kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse (sipas ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, sipas ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ligjit nr. 9396, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tyre, ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”).

a) për shfrytëzim të pasurive natyrore minerare (sipas ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij);

b) për peshkim dhe akuakulturë (ligji i peshkimit);

c) për përdorimin e ujërave;

d) për ndërtim të veprave hidroteknike (për shtrirje tubacionesh dhe ndërtim kanalesh për HEC-e (sipas kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ligjit nr. 9396, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar +koncesionet);

e) për ndërtimin e antenave të komunikimit radiotelevizive dhe telefonisë celulare (ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”);

f) për ndërtim të linjave elektrike e kabllove optike, instalimeve të naftës apo gazsjellës;

g) për vendosje kullash të ndryshme vrojtimi/sinjalizimi (ligji planifikimit të territorit);

h) ndërtim të kullave për parqe eolike dhe infrastrukturën ndihmëse (sipas ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”);

i) dhënia me qira e sipërfaqeve dhe infrastrukturës ndihmëse në rastet kur me ligj, me vendimin e Këshillit të Ministrave, me vendim të KKT-së ose me marrëveshje koncesionare, subjektit të licencuar i është dhënë leja e ushtrimit të veprimtarisë;

j) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 0.1 ha, të cilat jepen me afat deri në 1 (një) vit pa të drejtë rinovim kontrate;

k) sipërfaqe të fondit pyjor që do të përdoren për rehabilitim (pyllëzim dhe ripyllëzim).

24. Për të lidhur kontratën e qirasë në rastet sipas pikës 22 të këtij udhëzimi, subjekti paraqet pranë DSHP-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën për marrjen me qira të sipërfaqes;

b) projektin teknik, të shoqëruar me planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartë topografike të digjitalizuar dhe të gjeoreferuar me shkallë 1:10000 ose 1:25000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet eventuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të studimit apo projektit, kopje origjinale të miratuara;

c) vendimin e institucionit që ka miratuar projektin e zbatimit (ministër, këshilli mbikëqyrës, këshilli drejtues, bordi drejtues etj.);

d) planbiznesin dhe investimet për zhvillimin e aktivitetit;

e) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;

f) lejet, licencat apo autorizimet për ushtrimin e aktivitetit;

g) lejen e mjedisore, pëlqimin apo autorizimin mjedisor, nëse veprimtaria që do të ushtrojë ka ndikime negative në mjedis.

25. Për të lidhur kontratën sipas kërkesës në pikës 3 të këtij udhëzimi, subjekti paraqet në DSHP;

a) kërkesën;

b) projektin teknik, të shoqëruar me planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartë topografike të digjitalizuar dhe të gjeoreferuar me shkallë 1:10000 ose 1:25000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet eventuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të studimit apo projektit, kopje origjinale të miratuara;

c) lejet, licencat apo autorizimet për ushtrimin e aktivitetit.

26. Për kërkesat, sipas pikës 22 të këtij udhëzimi, DSHP-ja e shqyrton dosjen brenda 15 ditëve dhe, kur e gjen të rregullt, harton raportin teknik dhe e paraqet dosjen për miratim te ministri. Pas miratimit të ministrit, DSHP-ja dhe kërkuesi nënshkruajnë procesverbalin e dhënies së sipërfaqes dhe kontratën e qirasë tip të miratuar nga ministri.

27. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr. 2, datë 14.5.2009 “Për kriteret e konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor”, shfuqizohet.

28. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë dhe sektorët përkatës në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe DSHP-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

UDHËZIM
Nr. 10, datë 9.7.2012

MBI RREGULLAT NË TRANSPORTIN HEKURUDHOR TË UDHËTARËVE DHE TË BAGAZHEVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”;

Duke adaptuar rregulloren nr. 1371/2007 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2007 “Mbi të drejtat dhe detyrimet e udhëtarëve që lëvizin me hekurudhë”;

Me qëllim rregullimin, disiplinimin, monitorimin, transparencën e veprimtarisë së ushtruar nga personat juridikë në fushën e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe bagazheve, si edhe integrimin gradual të këtij transporti në tregun rajonal dhe europian të transportit hekurudhor, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit nxjerr këtë udhëzim.

KAPITULLI I PARË
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Ky udhëzim përcakton rregullat e detajuara lidhur me:

a) organizimin dhe drejtimin e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe bagazheve;

b) informacionet që duhet të ofrojnë transportuesit hekurudhorë, përfundimi i kontratave të transportit, lëshimi i biletave dhe zbatimi i një sistemi informacioni dhe rezervimi për transportet hekurudhore;

c) përgjegjësinë e transportuesve hekurudhorë dhe detyrimet e tyre të sigurimit për udhëtarët dhe bagazhet e tyre;

ç) detyrimet e transportuesve hekurudhorë kundrejt udhëtarëve në rast vonese të trenit;

d) mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar që udhëtojnë me tren dhe ndihma ndaj këtyre personave;

dh) përcaktimin dhe monitorimin e standardeve të cilësisë së shërbimit, administrimin e rreziqeve për sigurinë personale të udhëtarëve, si dhe trajtimin e ankesave;

e) rregullat e përgjithshme për zbatimin.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet në të gjithë sistemin hekurudhor shqiptar për të gjitha udhëtimet hekurudhore dhe shërbimet hekurudhore të ofruara nga një apo më shumë transportues hekurudhorë të licencuar në përputhje me rregulloren e licencimit të transportuesve hekurudhorë (rregullorja e ministrit nr. 2638, datë 10.6.2011, Fletorja Zyrtare nr. 96, faqe 3922).

2. Ky udhëzim nuk zbatohet për shërbimet e transportit dhe për transportuesit hekurudhorë, që nuk janë të licencuar sipas rregullores së ministrit të cituar në pikën 1, të këtij neni.

3. Ky udhëzim nuk zbatohet për shërbimet hekurudhore qytetëse dhe rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve dhe bagazheve.

Neni 3
Përkufizimet

Për qëllimet e këtij udhëzimi me termin:

1. “Transportues hekurudhor” kuptohet çka është përkufizuar në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

2. “Transportues” kuptojmë një transportues hekurudhor kontraktues, me të cilin udhëtari ka përfunduar kontratën e transportit ose një seri të transportuesve hekurudhorë të njëpasnjëshëm, të cilët janë përgjegjës në bazë të kësaj kontrate.

3. “Transportues zëvendësues” kuptojmë një transportues hekurudhor që nuk ka përfunduar kontratën e transportit me udhëtarin, por të cilit transportuesi hekurudhor, palë e kontratës, i ka besuar, në tërësi ose pjesërisht, kryerjen e transportit hekurudhor.

4. “Administrues i infrastrukturës” kuptojmë çka është përkufizuar në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

5. “Administrues i stacioneve” kuptojmë një njësi organizative në sistemin hekurudhor, i ngarkuar me administrimin e stacioneve hekurudhore, i cili mund të jetë edhe administruesi i infrastrukturës.

6. “Shitës bilete” kuptojmë çdo shitës me pakicë të shërbimeve të transportit hekurudhor që ka kontratë dhe shet bileta në emër të një transportuesi hekurudhor ose për llogari të vet.

7. “Kontrata e transportit” kuptojmë një kontratë transporti me ose pa pagesë ndërmjet një transportuesi hekurudhor ose një shitësi biletash dhe udhëtarit për ofrimin e një ose më shumë shërbimeve të transportit.

8. “Rezervim” kuptojmë një autorizim, në letër apo në formë elektronike, që i jep të drejtë transporti udhëtarit në trenin dhe vendin që ai ka rezervuar.

9. “Biletë direkte” kuptojmë një ose shumë bileta që përfaqësojnë një kontratë transporti, për shërbime hekurudhore të njëpasnjëshme, të ofruara nga një ose shumë transportues hekurudhorë.

10. “Shërbim hekurudhor i brendshëm i transportit të udhëtarëve” kuptojmë një shërbim hekurudhor i transportit të udhëtarëve në kuadrin e të cilit treni nuk kalon kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

11. “Vonesë” kuptojmë ndryshimin e kohës ndërmjet orës që udhëtari duhet të mbërrinte sipas grafikut të publikuar dhe orës së mbërritjes reale ose të parashikuar.

12. “Abone” kuptojmë një biletë për një numër të kufizuar udhëtimesh, që lejon mbajtësin e autorizuar që të udhëtojë me hekurudhë në një itinerar të caktuar ose në një rrjet të veçantë gjatë një periudhe të përcaktuar.

13. “Sistem i informacionit dhe rezervimit për transportin hekurudhor” kuptojmë një sistem që përmban informacione mbi shërbimet hekurudhore të ofruara nga transportuesit hekurudhorë.

Informacionet lidhur me shërbimet për udhëtarët të grumbulluara në këtë sistem duhet të përfshijnë informacione mbi:

a) kalendarin dhe oraret e shërbimeve të udhëtarëve;

b) disponueshmërinë e vendeve të shërbimeve të udhëtarëve;

c) tarifat dhe kushtet e veçanta;

ç) mundësinë e hyrjes në trena të personave me aftësi të kufizuar dhe të personave me lëvizshmëri të reduktuar;

d) pajisjet me anë të të cilave mund të bëhen rezervimet ose të jepen bileta udhëtimi, për aq sa një pjesë ose të gjitha këto pajisje janë në dispozicion të përdoruesit.

Sistemi i informacionit dhe i rezervimit për transportin hekurudhor mund të jetë edhe i informatizuar.

14 “Person me aftësi të kufizuara” ose “person me lëvizshmëri të reduktuar” kuptojmë çdo person, lëvizshmëria e të cilit është e kufizuar gjatë përdorimit të një mjeti transporti për arsye të ndonjë paaftësie fizike të tij (shqisore ose lëvizëse, e përhershme ose e përkohshme) ose të çdo paaftësie, ose dëmtimi intelektual, ose të çdo shkaku tjetër të paaftësisë apo si rezultat i moshës, dhe gjendja e të cilit kërkon vëmendjen e duhur dhe përshtatjen e nevojave të tij.

15. “Kushtet e përgjithshme të transportit” kuptojmë kushtet e transportuesit në formën e kushteve të përgjithshme ose të tarifave ligjërisht të zbatueshme në sistemin hekurudhor shqiptar dhe që, me përfundimin e kontratës së transportit, bëhen pjesë përbërëse e tij.

16. “Mjet” kuptojmë një mjet tërheqës ose një vagon që lëviz për kryerjen e transportit të udhëtarëve.

KAPITULLI II
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E UDHËTARËVE NË TRANSPORTIN HEKURUDHOR

Neni 4
Kontrata e transportit, informacioni dhe biletat

1. Bileta e transportit përbën lidhjen dhe përmbajtjen e kontratës së transportit ndërmjet udhëtarit dhe transportuesit hekurudhor. Ky i fundit merr përsipër dërgimin e udhëtarit në destinacionin e përcaktuar në biletë, sipas grafikut të lëvizjes së publikuar.

2. Sipas dispozitave të këtij udhëzimi, përfundimi dhe realizimi i kontratës së transportit kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil dhe të Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5
Përjashtimi dhe kushtet e kufizimeve

1. Detyrimet ndaj udhëtarëve që rezultojnë nga ky udhëzim nuk mund të bëhen objekt i një kufizimi ose i një përjashtimi.

2. Transportuesit hekurudhorë mund të ofrojnë kushte kontraktuese më të favorshme për udhëtarët se kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 6
Detyrimi i informimit lidhur me ndërprerjen e shërbimeve

Transportuesit hekurudhorë ose, nëse duhet, autoritetet kompetente përgjegjëse për një kontratë hekurudhore të shërbimit publik duhet të publikojnë vendimet e ndërprerjes së shërbimeve me anë të mjeteve të përshtatshme dhe para zbatimit të tyre.

Neni 7
Informacione mbi udhëtimet

1. Transportuesit hekurudhorë dhe shitësit e biletave, duke ofruar biletat e udhëtimit në emër të një ose më shumë transportuesve hekurudhorë u japin udhëtarëve para udhëtimit, me kërkesën e tyre, të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) kushtet e përgjithshme të zbatimit të kontratës;

b) oraret dhe kushtet për një udhëtim më të shpejtë;

c) oraret dhe kushtet për tarifat më të ulëta;

ç) mundësinë, kushtet e hyrjes dhe të disponibilitetit në tren të pajisjeve për personat me aftësi dhe lëvizshmëri të kufizuar;

d) mundësinë dhe kushtet e hyrjes së biçikletave;

dh) mundësinë e vendeve të qëndrimit në zonat që pihet ose jo duhan, në klasin e parë dhe të dytë, vendet e fjetjes në vagonët për fjetje;

e) aktivitetet që mund të ndërpresin ose të vonojnë shërbimet;

ë) disponibilitetin e shërbimeve në bordin e trenave;

f) procedurat e reklamimit të bagazheve të humbura;

g) procedurat e depozitimit të ankesave;

2. Transportuesit hekurudhorë u sigurojnë udhëtarëve gjatë udhëtimit të paktën informacionet e mëposhtme:

a) shërbimin që ofrohet në bordin e trenave;

b) stacionin vijues;

c) vonesat;

ç) korrespondencat kryesore;

d) çështjet që lidhen me sigurinë.

3. Informacioni i përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni ofrohet në formën më të përshtatshme. Vëmendje e veçantë në këtë drejtim duhet t'u kushtohet personave që janë me dëmtime të shikimit ose të dëgjimit.

Neni 8
Vlefshmëria e biletave dhe rezervimet

1. Transportuesit hekurudhorë dhe shitësit e biletave ofrojnë bileta udhëtimi dhe bëjnë rezervime.

2. Pa cenuar pikën 3 të këtij neni, transportuesit hekurudhorë shpërndajnë biletat për udhëtarët me të paktën në një nga mënyrat e mëposhtme të shitjes:

a) sportelet ose makinat automatike;

b) telefonit, internetit apo çdo teknologjie tjetër e përdorur gjerësisht;

c) në trena gjatë lëvizjes.

3. Transportuesit hekurudhorë ofrojnë mundësinë për të marrë bileta për shërbimin përkatës në bordin e trenit, vetëm nëse kjo mundësi kufizohet ose refuzohet në vendet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni për arsye që lidhen me sigurinë ose luftën kundër mashtrimit, të arsyeve të rezervimit të detyrueshëm të trenit apo për shkaqe të arsyeshme tregtare.

4. Kur në stacionin e nisjes nuk ka zyrë ose makinë për të shitur bileta, atëherë udhëtarët duhet të informohen në stacionin e nisjes lidhur me procedurën e blerjes së biletave.

Neni 9

Përgjegjësia e transportuesve hekurudhorë për udhëtarët dhe bagazhet e tyre

Përgjegjësia e transportuesve hekurudhorë në lidhje me udhëtarët dhe bagazhet e tyre, si dhe kompensimet e mëtejshme për dëmet ndaj tyre në rastin e:

a) vdekjes apo plagosjes nga aksidentet apo incidentet;

b) vonesën e trenave, korrespondencën e munguar, anulimin e trenave, ndërprerjen e udhëtimit;

c) kompensimin e çmimit të biletave;

ç) kompensimin e vonesave;

d) siguracioni i udhëtimit;

rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit Civil dhe Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10

Asistenca ndaj udhëtarëve

1. Në rastin e një vonese në mbërritje ose në nisje, transportuesit hekurudhorë ose administruesit e infrastrukturës informojnë udhëtarin për situatën, si dhe për orën e nisjes apo të mbërritjes të parashikuar nëse këto informacione ai i disponon.

2. Në rast se treni është bllokuar në perigon ose në stacionin hekurudhor, udhëtarëve u ofrohet transporti me tren nga vendndalimi i trenit deri në pikën e nisjes apo në stacionin e destinacionit final të shërbimit, nëse kjo është e mundur.

3. Nëse shërbimi hekurudhor nuk mund të vazhdohet më, transportuesit hekurudhorë do të organizojnë sa më shpejt të jetë e mundur shërbimet alternative të transportit të udhëtarëve.

4. Transportuesi hekurudhor, me kërkesë të udhëtarit, vërteton në biletë se shërbimi hekurudhor për të cilin ai ka marrë biletë direkte ka pësuar një vonesë, ka çuar në një lidhje të humbur ose që është anuluar.

5. Në zbatimin e paragrafëve 1, 2 dhe 3, transportuesit hekurudhorë në fjalë u kushtojnë vëmendje të veçantë nevojave të personave me aftësi të kufizuar dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar dhe çdo personi që i shoqëron ata.

Neni 11

E drejta për të transportuar personat me aftësi të kufizuar dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar

1. Transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e stacioneve hartojnë dhe zbatojnë rregulla për pjesëmarrjen e padiskriminuar në transport të personave me aftësi të kufizuar dhe të personave me lëvizshmëri të reduktuar, duke u konsultuar me organizatat që i përfaqësojnë ata.

2. Transportuesi hekurudhor dhe shitësi i biletave nuk mund të refuzojnë një rezervimin ose shitjen e një biletë për një person me aftësi të kufizuar, ose një personi me lëvizshmëri të reduktuar. Në vartësi të kushteve specifike ata mund të kërkojnë që personi i tillë të shoqërohet nga një person tjetër.

3. Me kërkesë, një transportues hekurudhor apo një shitës biletash duhet t'u sigurojë personave me aftësi të kufizuar dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar informacion mbi mundësinë e shërbimeve hekurudhore, si dhe kushtet e hyrjes në mjetet lëvizëse.

4. Kur një transportues hekurudhor ose shitësi i biletave nuk mund të zbatojë rregullat e parashikuara në këtë nen, ata duhet të informojnë me shkrim personin me aftësi të kufizuar apo personin me lëvizshmëri të reduktuar për arsyet në fjalë, brenda pesë ditëve pune nga refuzimi për të bërë rezervimin ose për të dhënë biletën, ose imponimi për të qenë i shoqëruar.

5. Pa prekur rregullat që i referohen këtij neni transportuesit hekurudhorë duhet t'u sigurojnë personave me aftësi të kufizuar dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar ndihmë falas në bordin e një treni dhe gjatë hipjes në tren dhe zbritjes nga treni.

Neni 12
Siguria e udhëtarëve

Transportuesit hekurudhorë, administruesit e infrastrukturës dhe administruesit e stacioneve marrin masat e duhura sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë për të garantuar lëvizjen e sigurt të udhëtarëve në stacionet hekurudhore dhe në trena dhe për të administruar rreziqet. Ata bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacione për praktikat më të mira në lidhje me parandalimin e veprimeve, të cilat mund të përkeqësojnë nivelin e sigurisë.

Neni 13
Ankesat

1. Transportuesit hekurudhorë janë të detyruar që të publikojnë procedurën për trajtimin e ankesave lidhur me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Udhëtarët mund të paraqesin ankesën tek transportuesi hekurudhor. Brenda një muaji, marrësi i ankesës, jep një përgjigje të arsyetuar mbi të gjitha çështjet e ngritura në të.

3. Transportuesi hekurudhor, në raportin vjetor që i referohet nenit të mëposhtëm, publikon numrin dhe kategoritë e ankesave të marra, ankesat e trajtuara, afatet e përgjigjeve dhe veprimet e ndërmarra për përmirësimin e situatës.

Neni 14
Standardet e cilësisë së shërbimit

1. Transportuesit hekurudhorë përcaktojnë standardet e cilësisë së shërbimit dhe zbatojnë një sistem të administrimit të cilësisë për ta ruajtur këtë cilësi. Standardet e cilësisë së shërbimit të paktën duhet të mbulojnë çështjet e mëposhtme:

a) informacionet dhe biletat;

b) përpikëria e shërbimeve dhe parimet e përgjithshme për të kapërcyer çrregullimet e shërbimeve;

c) pastërtia e mjeteve lëvizëse dhe e mjediseve të stacioneve (cilësia e ajrit në vagonë, higjiena e pajisjeve sanitare etj.);

ç) evidentimi i plotësimit të kërkesave të udhëtarëve;

d) trajtimi i ankesave, rimbursimet, kompensimet në rastin e mosrespektimit të standardeve të cilësisë së shërbimit;

dh) asistenca në rastin e personave me aftësi të kufizuar dhe e personave me lëvizshmëri të reduktuar.

2. Transportuesit hekurudhorë monitorojnë punën e tyre sipas standardeve të cilësisë së shërbimit. Ata publikojnë çdo vit një raport vlerësimi mbi ecurinë e cilësisë së tyre të shërbimit, së bashku me raportin e tyre vjetor. Raportet mbi ecurinë e cilësisë së shërbimit publikohen në faqen e internetit të transportuesve hekurudhorë.

Neni 15
Informacione për udhëtarët mbi të drejtat e tyre

1. Kur shesin bileta për udhëtimet me hekurudhë, transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e stacionit informojnë udhëtarët për të drejtat dhe detyrimet e tyre në zbatim të këtij udhëzimi.

2. Transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e stacioneve informojnë udhëtarët, në stacion dhe në tren, për detajet e pikave të kontaktit lidhur ankimet për cilësinë e shërbimit.

3. Çdo udhëtar mund të ankohet te ministri ose tek organi i caktuar prej tij në lidhje me shkeljet e të drejtave të tij të përcaktuara nga ky udhëzim.

Neni 16
Te drejtat e udhëtarit në trenat e udhëtarëve

1. Gjatë udhëtimit në trena, udhëtari mund:

a) të marrë me vete bagazhe dore pa pagesë deri në 20 kg, të cilat mund të vendosen në vendin e caktuar për këtë qëllim;

b) të marrë me vete dhe t'i ketë kujdes vetë kafshë të vogla shtëpiake, të lejueshme për transportin hekurudhor;

c) të dëmshpërblehet sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast aksidenti apo incidenti, të ndodhur gjatë udhëtimit me tren.

2. Për probleme që mund t'i lindin kur është në tren, udhëtari mund t'i drejtohet personelit të trenit.

Neni 17
Detyrimet e udhëtarëve

1. Udhëtarët kanë për detyrë:

a) të pajisen me biletë udhëtimi apo me biletë bagazhi për bagazhin e tyre;

b) të ruajnë biletën e udhëtimit apo të bagazhit në gjendje të mirë deri në fund të udhëtimit dhe t'i paraqesë ato kur i kërkohet nga personeli i shërbimit dhe i kontrollit;

c) të mbajë pastër vendin e qëndrimit;

ç) të zhdëmtojë vlerën e dëmit të shkaktuar prej tij në tren apo në mjediset e stacionit;

d) gjatë kalimit të tij nga një tren tek tjetri në stacionet e korrespondencës të kujdeset vetë për transferimin e bagazheve të dorës që ai mban me vete.

dh) të zbatojë rregullat e shërbimit në stacione dhe në tren gjatë udhëtimit dhe të veprojë sipas porosive të personelit të shërbimit;

e) të kujdeset vetë për hipjen në tren dhe zbritjen nga treni.

2. Udhëtarëve u ndalohet:

a) transportimi i lëndëve djegëse, plasëse, helmuese, gërryese dhe i lëndëve të tjera të kësaj natyre;

b) transportimi i gjësë së gjallë në vagonët e udhëtarëve;

c) hipja në tren pasi të jetë dhënë sinjali për nisjen e tij;

ç) prishja e qetësisë në tren dhe shqetësimi i udhëtarëve të tjerë;

d) përkulja nga dritaret, hapja e dyerve të vagonit, qëndrimi në urat kaluese, në dyer, shkallë e parakolpe kur treni është në lëvizje;

dh) hedhja nga vagoni e çfarëdolloj sendi;

e) ndotja e mjedisit në stacion dhe në vagon;

ë) pirja e duhanit në mjediset e palejuara;

f) përdorimi në tren i pijeve alkoolike dhe narkotike;

g) hipja dhe zbritja nga treni në vendet e paparashikuara në orarin e lëvizjes së trenave;

gj) përdorimi i frenit të sigurimit.

Neni 18
Përjashtimi nga transporti

Udhëtaret që:
a) shkelin rregullat e përcaktuara në nenin e mëparshëm, pika "f";
b) cenojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurimit të lëvizjes së trenave;
c) me veprimet e tyre shqetësojnë rëndë udhëtarët e tjerë;
ç) shkelin rregullat e përcaktuara për rendin publik;
mund të përjashtohen nga transporti në stacionin më të afërt.

KAPITULLI III
ORGANIZIMI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Neni 19
E drejta për të ushtruar veprimtarinë e transportit hekurudhor të udhëtarëve

1. Të drejtën për të ushtruar veprimtarinë e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe bagazheve e kanë ata transportues hekurudhorë, të cilët janë të licencuar për kryerjen e një aktiviteti të tillë nga autoriteti përkatës i licencimit;

2. Para se të fillojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve, transportuesit hekurudhorë duhet të lidhin kontratat përkatëse me administruesit e infrastrukturës lidhur me sigurimin e rrugëkalimeve të trenave, kryerjen e pagesave të përdorimit të infrastrukturës, miratimin e grafikut të lëvizjes së trenave etj.

3. Para se të fillojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve, transportuesit hekurudhorë duhet të pajisen me certifikatën përkatëse të sigurisë nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.

Neni 20
Transporti i bagazheve të dorës

1. Udhëtari, gjatë udhëtimit, mund të mund të marrë falas me vete në vagonë objekte të lehta për t'u mbajtur (bagazhe dore).

2. Çdo udhëtar ka në dispozicion për bagazhet e tij të dorës vetëm një hapësirë të vendosur mbi dhe nën vendin që ai zë ose një hapësirë tjetër korresponduese kur vagonët janë të një tipi special, sidomos kur ato përmbajnë një depo për bagazhet e dorës.

3. Nuk mund të futen në vagonë si bagazhe dore:
a) lëndët dhe objektet e rrezikshme, të përjashtuara nga transporti;
b) objektet e një natyre që shqetësojnë ose mërzisin udhëtarët ose shkaktojnë një dëm;
c) objektet që dispozitat e doganës ose të autoriteteve të tjera administrative nuk i lejojnë që të vendosen në vagonë;
ç) kafshët e gjalla, përveç përjashtimeve të veçanta të parashikuara nga ky udhëzim.

4. Pranohen për transport, si bagazhe dore, valixhe dhe çanta udhëtimi, baule dhe shporta të vogla, të cilat lehtësisht mund të vendosen në hapësirën që është në dispozicion të udhëtarit.

Neni 21
Pranimi i bagazheve

1. Pranohen për transport si bagazhe, objekte të tilla që nuk janë bagazhe dore, nuk kanë peshë mbi 50 kg dhe nuk kanë gabarite të mëdha, me qëllim që të mund të futen në vagonët e bagazheve.

2. Përjashtohen nga transporti si bagazhe:
a) lëndët dhe objektet e rrezikshme, sidomos armët e mbushura, lëndët dhe objektet eksplozive ose që ndizen, lëndët djegëse, toksike, radioaktive ose korrozive, si dhe lëndët me erë të keqe ose infektive;

b) objektet kaba me një masë të madhe;

c) kafshët e gjalla që duan përkujdesje të vazhdueshme.

Neni 22

Dorëzimi i bagazheve në stacionin e nisjes dhe transporti i tyre

1. Udhëtari i dorëzon bagazhin punonjësit që shërben në vagonin përkatës të bagazheve të trenit të udhëtarëve;

2. Dorëzimi i bagazheve bëhet vetëm me paraqitjen e biletave të bagazheve të marra në biletaritë e shitjes së biletave, të cilat janë të vlefshme deri në destinacionin e bagazheve. Në rast se udhëtari nuk është pajisur me biletën përkatëse të bagazheve për arsye që nuk varen prej tij, atëherë punonjësi i transportuesit hekurudhor që shërben në vagonin e bagazheve e pajis atë me biletën përkatëse të bagazheve.

3. Transportuesi hekurudhor bën transferimin e bagazheve nga një tren në tjetrin në stacionet e korrespondencës ku udhëtari ndërron tren.

4. Përveç ndonjë përjashtimi të parashikuar nga transportuesi hekurudhor, çmimi i transportit të bagazheve duhet të paguhet para fillimit të udhëtimit.

5. Transportuesit hekurudhorë mund të përjashtojnë ose të kufizojnë transportin e bagazheve në disa trena ose në disa kategori të trenave ose me destinacion dhe ardhje nga disa stacione.

6. Me marrjen e bagazhit në dorëzim, transportuesi hekurudhor është përgjegjës për transportin e sigurt të tij deri në stacionin e destinacionit.

Neni 23

Dorëzimi i bagazheve në stacionin e mbërritjes

1. Bagazhet i dorëzohen udhëtarit në stacionin e mbërritjes, pasi ai ka paraqitur kundërbiletën.

2. Mbajtësi i kundërbiletës, të cilit bagazhet nuk i janë dorëzuar konform pikës 1 të këtij neni, mund të bëjë ankimim tek transportuesi hekurudhor.

3. Udhëtari ka të drejtën e ankimimit edhe në rastin kur bagazhi që ai ka dorëzuar është dëmtuar gjatë udhëtimit.

Neni 24

Pranimi i kafshëve në vagonët e udhëtarëve

1. Me qëllim sigurimin e kushteve komode në transportin e udhëtarëve, si rregull, kafshët e gjalla nuk lejohen të futen në vagonët e udhëtarëve;

2. Në vagonët e udhëtarëve mund të lejohet futja e kafshëve të vogla shtëpiake, të mbyllura në kafaz, shporta apo ambalazhe të tjera të përshtatshme, me kusht që ky transport të mos cenojë dispozitat veterinare dhe sanitare.

Shpendët dhe kafshët e imta nuk konsiderohen si kafshë shtëpiake.

3. Qentë e vegjël mund të futen në vagon edhe nëse nuk janë të mbyllur në kafaz, me kusht që udhëtari t'i mbajë në prehër. Si qen i vogël konsiderohet ai, lartësia e të cilit, nga toka deri te kurrizi nuk kalon 40 cm.

Mbikëqyrja e kafshëve që udhëtari merr me vete në vagon i takon udhëtarit.

4. Udhëtari është përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara nga kafshët që ai merr me vete në vagon, përveç kur ai provon që dëmi është shkaktuar nga një gabim i transportuesit hekurudhor ose nga një gabim i një të treti.

Neni 25
Transporti i biçikletave

Transportuesit hekurudhorë u mundësojnë udhëtarëve transportin e biçikletave të tyre me tren në vagonin e bagazheve kundrejt një tarife, nëse ato janë të lehta për t'u trajtuar dhe nëse kjo nuk do të ndikojë negativisht në shërbimin specifik hekurudhor dhe nëse mjetet hekurudhore e lejojnë këtë shërbim.

KAPITULLI IV
DETYRAT E TRANSPORTUESVE HEKURUDHORË

Neni 26
Biletat e udhëtimit

1. Transportuesit hekurudhorë organizojnë pajisjen e udhëtarëve me bileta udhëtimi dhe bileta bagazhesh. Shitja e biletave të tilla mund t'u delegohet edhe agjencive të udhëtimit.

2. Biletat e udhëtimit, si rregull, janë të njëjta në formë, madhësi, si dhe nga mbishkrimet mbi to.

3. Biletat e udhëtimit përmbajnë të paktën mbishkrimet e mëposhtme:

a) stacionin e nisjes dhe të mbërritjes;

b) çmimin e biletës së udhëtimit;

c) numrin rendor;

ç) serinë e biletës;

d) vulën e stacionit të nisjes;

dh) datën e udhëtimit;

e) primin e sigurimit të detyrueshëm të udhëtarit;

ë) siglën e transportuesit hekurudhor.

Mbishkrimet e parashikuara në germat "a", "d" dhe "dh" mund të vendosen me vulën datare të stacionit të nisjes.

4. Biletat e bagazheve përmbajnë të paktën mbishkrimet e mëposhtme:

a) stacionin e nisjes dhe të mbërritjes;

b) peshën;

c) çmimin e udhëtimit;

dh) numrin rendor të biletës;

e) vulën e stacionit të nisjes;

ë) datën e udhëtimit;

f) siglën e transportuesit hekurudhor.

5. Biletat e udhëtimit në transportin e udhëtarëve dhe bagazheve brenda vendit shtypen në gjuhën shqipe, ndërsa biletat për transportin ndërkombëtar shtypen edhe në një gjuhë të huaj, për të cilën është rënë dakord paraprakisht me marrëveshjet përkatëse.

6. Në transportin hekurudhor të udhëtarëve brenda vendit përdoren tipat e mëposhtëm të biletave të udhëtimit;

a) biletat e zakonshme për një udhëtim;

b) biletat për udhëtimet vajtje-kthim;

c) bileta abone për 10 ditë pune për punonjës apo studentë;

ç) bileta për udhëtarë me tarifë të ulur, të përfituar nga ligjet përkatëse.

7. Formatet dhe tipat e biletave të udhëtimit dhe të biletave të bagazheve që përmbajnë të paktën mbishkrimet e përmendura në pikat 3 dhe 4 të këtij neni hartohen dhe miratohen nga transportuesit hekurudhorë.

Neni 27
Vulosja e biletave të udhëtimit

1. Biletat e udhëtimit vulosen si më poshtë:

a) me makinë;

b) me vulën me datë të stacionit;

c) me shenjëzues biletash.

Nëse shitësi i biletave nuk ka shenjëzues, çdo biletë udhëtimi vuloset më vete, me vulën datare të stacionit.

Transportuesit hekurudhorë përcaktojnë rregullat dhe mbajnë përgjegjësi për procedurat e vulosjes së biletave të udhëtimit në përputhje me legjislacionin kombëtar të fushës.

2. Ndalohet dhënia e biletave të pavulosura, të vulosura dy herë ose e biletave që kanë vula të paqarta dhe të palexueshme. Këto bileta konsiderohet të parregullta.

Neni 28
Detyrat e shoqëruesit të vagonëve në trenat e udhëtarëve

1. Përveç detyrave të tjera në fushën e pajisjes me dëshmi aftësie dhe të kualifikimeve të vazhdueshme, detyrat e shoqëruesit të vagonëve gjatë shërbimit në trena janë si më poshtë:

a) kontrollon në vazhdimësi dhe pas çdo ndalimi të trenit pajisjen e udhëtarëve me bileta udhëtimi;

b) kujdeset që dyert e vagonit gjatë lëvizjes së trenave të jenë të mbyllura dhe të siguruara;

c) mban vagonin të rregullt dhe të pastër;

ç) të ketë sjellje të kujdesshme me udhëtarët, të jetë i komunikueshëm dhe të jetë i gatshëm për t'u shërbyer atyre;

d) vendos rregull në hyrjen dhe daljen e udhëtarëve në vagonë, duke qëndruar vetë pranë derës për të mënjanuar çdo konfuzion dhe rrezik për ta;

dh) nuk lejon hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve kur treni është në lëvizje;

e) nuk lejon qëndrimin e udhëtarëve në urat lidhëse ndërmjet vagonëve dhe në shkallët e tyre;

ë) u transmeton udhëtarëve informacione të plota e të sakta lidhur me grafikun e lëvizjes së trenave;

f) kujdeset për ruajtjen e komoditetit të brendshëm të vagonit që ka në ngarkim;

g) i raporton kryetarit të trenit për problemet dhe parregullsitë që evidenton gjatë udhëtimit të trenit, problemet që lidhen me pjesën e brendshme të vagonit dhe dëmtimet e mundshme;

gj) bashkëpunon me organet e policisë për të gjitha shqetësimet që kanë të bëjnë me rendin publik gjatë udhëtimit të trenave;

h) merr masat e duhura për eliminimin e parregullsive brenda mundësive të tij.

2. Transportuesi hekurudhor mund të caktojë detyra të tjera shtesë për shoqëruesin e vagonit lidhur me mirëfunksionimin e shërbimit hekurudhor të udhëtarëve.

Neni 29
Detyrat e kryetarit të trenit të udhëtarëve

1. Përveç detyrave lidhur me pajisjen me dëshmi aftësie dhe të kualifikimeve të vazhdueshme profesionale, kryetari i trenit të udhëtarëve gjatë ushtrimit të detyrës së tij, ka të paktën detyrat e mëposhtme:

a) ushtron kontroll mbi pajisjen e udhëtarëve me bileta udhëtimi dhe bileta bagazhesh;

b) kontrollon shoqëruesit e vagonëve lidhur me pajisjen e udhëtarëve me bileta udhëtimi;

c) kontrollon paraqitjen e rregullt dhe në kohën e duhur të personelit shoqërues të trenit dhe zbatimin e detyrave nga ana e tyre;

ç) kontrollon para nisjes formimin e trenit, nëse ky formim është bërë në përputhje me rregullat në fuqi;

d) kujdeset për kryerjen e kontrollit teknik të vagonëve dhe të provave të frenave në të gjitha stacionet e parashikuara;

dh) ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi funksionimin e rregullt të dyerve dhe mbylljen e tyre gjatë udhëtimit;

e) është përgjegjës për kryerjen e detyrave nga punonjësit e shërbimit në tren dhe sjelljen e rregullt ndaj udhëtarëve;

ë) verifikon dhe mbledh të dhëna për numrin e udhëtarëve sipas itinerareve të lëvizjes së trenave, si dhe evidenton sugjerimet e udhëtarëve lidhur me nivelin e shërbimit;

f) kontrollon vazhdimisht gjendjen e mjediseve të brendshme të vagonëve, cilësinë e pastrimit, furnizimin me ujë të depozitave, funksionimin e aparaturave të ndriçimit, të ventilimit, të fonisë, ndjek rregullsinë e pajisjeve dhe pjesëve të inventarit të vagonëve etj.;

g) mbledh të dhëna për trenin që lidhen me nevojat e udhëtarëve, orarin e trenave, punën e punonjësve, komfortin e udhëtimit etj.;

gj) kontrollon nëse bagazhet e pranuara për transport kanë dokumentacionin përkatës të transportit, nëse janë pranuar për transport sipas rregullave të miratuara, nëse janë sistemuar në rregull në vagon etj.;

h) në përfundim të udhëtimit përgatit informacionin përkatës lidhur me ecurinë ditore të udhëtimit, problemet e konstatuara dhe masat e marra për eliminimin e tyre.

2. Transportuesi hekurudhor mund të caktojë detyra të tjera shtesë për kryetarin e trenit lidhur me mirëfunksionimin e shërbimit hekurudhor të udhëtarëve.

KAPITULLI V
DETYRAT E ADMINISTRUESVE TË INFRASTRUKTURËS

Neni 30
Detyrat e administruesve të infrastrukturës hekurudhore

1. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore ka për detyrë:

a) krijimin e kushteve të përshtatshme dhe cilësore në mjediset e godinave të stacioneve të qëndrimit të udhëtarëve sipas standardeve të përcaktuara;

b) krijimin e kushteve të përshtatshme në stacione për hipjen në trena dhe daljen prej tyre;

c) pajisjen me peronet e domosdoshme të çdo linje të stacioneve që përdoret për shërbimet ndaj udhëtarëve;

ç) të pajisë stacionet e udhëtarëve me sinjalistikën dhe foninë e nevojshme;

d) t'u ofrojë udhëtarëve një informacion të plotë për oraret e lëvizjes së trenave, të korrespondencave, të vonesës së trenave dhe të trenave të anuluar;

dh) të krijojë kushtet e nevojshme të infrastrukturës hekurudhore për organizimin, drejtimin dhe lëvizjen e sigurt të trenave në stacione dhe në vijën hekurudhore;

e) në kushtet e konstatimit të dëmtimit të vijës hekurudhore, e cila nuk bën të mundur qarkullimin e trenave, njofton menjëherë transportuesin hekurudhor. Në këto raste merr masa të menjëhershme për riparimin e vijës hekurudhore dhe rivendosjen e lëvizjes së sigurt të trenave në një kohë sa më të shkurtër të mundshme;

ë) të krijojë kushtet e domosdoshme për trajtimin e barabartë, jodiskriminues dhe në kushte të njëjta të transportuesve hekurudhorë të transportit të udhëtarëve për dhënien e rrugëkalimeve dhe tarifave të njëjta të përdorimit të infrastrukturës hekurudhore;

f) të marrë masat e duhura për krijimin e kushteve të domosdoshme të hipjes në trena dhe të zbritjes nga treni të personave me aftësi të kufizuar dhe me lëvizshmëri të kufizuar.

KAPITULLI VI
KUALIFIKIMI I PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT HEKURUDHOR TË UDHËTARËVE

Neni 31
Pajisja e punonjësve me dëshmi aftësie

1. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" dhe të rregulloreve dhe të udhëzimeve të dala në zbatim të tij, personeli që realizon shërbimin hekurudhor të udhëtarëve dhe pikërisht makinisti, ndihmësmakinisti, kryetari i trenit, shoqëruesi i vagonit, mekaniku kontrollor i trenit duhet të pajisen me dëshmi aftësie.

2. Transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e infrastrukturës janë përgjegjës për aftësimin dhe riaftësimin profesional të punonjësve që realizojnë shërbimin hekurudhor të udhëtarëve.

3. Punonjësit e cituar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni merren në provë dhe pajisen me dëshmi aftësie nga një komision i veçantë pranë Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor.

Neni 32
Programet e aftësimit dhe të riaftësimit

Në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë, punonjësit përkatës të transportuesit hekurudhor që pajisen me dëshmi aftësie, realizojnë programet e aftësimit dhe të riaftësimit, të hartuara në bazë të dispozitave përkatëse në fuqi.

KAPITULLI VII
TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR I UDHËTARËVE

Neni 33
Baza ligjore e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve

Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve realizohet sipas dispozitave të:

a) Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF);

b)Rregullat uniforme në lidhje me kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve dhe të bagazheve (CIV)

c) Marrëveshjeve dypalëshe shtetërore të transportit hekurudhor me vendet fqinje.

ç) Marrëveshjeve dypalëshe të lidhura në nivelin e administruesve të infrastrukturave të vendit tonë me administruesit e infrastrukturave të vendeve fqinje.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

UDHËZIM
Nr. 10, datë 10.7.2012

PËR MASAT PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE TË LIRIMIT DHE TË MATURËS SHTETËRORE 2012

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit Ministrave nr. 78, datë 8.2.2006 "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publikë", të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit Ministrave nr. 1013, datë l0.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)",

UDHËZOJ:

KREU I
SESIONI I DYTË I PROVIMEVE TË LIRIMIT

1. Provimet e sesionit të dytë të provimeve të lirimit 2012 të zhvillohen në datat si më poshtë:
a) Gjuha shqipe dhe letërsia 3 shtator 2012;
b) Matematika 5 shtator 2012.
2. Në sesionin e dytë, provimet e lirimit të fillojnë në orën 10:00.
3. Procedurat e hartimit të testeve përcaktohen në rregulloren "Për provimet e lirimit në Republikën e Shqipërisë", nr. 1298, datë 24.2.2012.
4. Provimet e lirimit zgjasin 2 orë e 30 minuta.

PROVIMET E SESIONIT TË DYTË TË MATURËS SHTETËRORE

2. Provimet e sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2012 të zhvillohen në datat:
c) Gjuha shqipe dhe letërsia 7 shtator 2012;
d) Matematika 11 shtator 2012;
e) Provimet me zgjedhje 14 shtator 2012.
3. Në sesionin e dytë, provimet e Maturës Shtetërore të fillojnë në orën 10:00.
4. Testi për secilin nga provimet e detyruara të përmbajë 25 kërkesa, nga të cilat 13 kërkesa të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 13 pikë, kurse 12 kërkesa të jenë me zhvillim dhe të vlerësohen me 37 pikë.
5. Provimet e 1ëndëve të detyruara të zgjasin 2 orë e 30 minuta secila. Procedurat e hartimit të testeve përcaktohen në rregulloren "Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", nr. 33, datë 6.1.2012.
6. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje të përmbajë 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 10 pikë, kurse 20 pyetje të jenë me zhvillim dhe të vlerësohen me 30 pikë.
7. Provimet e lëndëve me zgjedhje të zgjasin 3 orë.

KREU II
MATURANTËT/KANDIDATËT QË DO TË MARRIN PJESË NË PROVIMET E SESIONIT TË DYTË TË MATURËS SHTETËRORE 2012

8. Në provimet e sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2012 kanë të drejtë të marrin pjesë:
a) Maturantët/kandidatët që rezultuan mbetës në një ose më shumë provime në sesionin e parë të Maturës Shtetërore 2012;

b) Maturantë që rezultuan mbetës në vitin shkollor 2011-2012 dhe i shlyejnë provimet shkollore në datat 27 dhe 29 gusht 2012;

c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2012, por nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe për arsye të ndryshme, nuk kanë plotësuar formularin A1Z.

d) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit dhe kanë njehsuar dokumentet shkollore në komisionin e posaçëm të ngritur në MASH.

9. Për maturantët e pikave 9/a, b është i vlershëm formulari Al për dhënien e provimeve të sesionit të dytë.

10. Kandidatët e pikave 9/c, d që do të japin provimet në sesionin e dytë, të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që i cakton DAR/ZA e vendbanimit. Për këtë kategori plotësimi i formularit A1Z do të bëhet nga data 30 gusht deri 3 shtator 2012.

11. Drejtori i shkollës të dërgojë zyrtarisht në DAR/ZA listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2012, në datën 4 shtator 2012. Drejtori i DAR/ZA-së dërgon këtë listë në AKP në datën 4 shtator 2012.

KREU III
ADMINISTRIMI I PROVIMEVE

12. Provimet të zhvillohen të përqendruara në drejtoritë arsimore rajonale.

13. Drejtoritë arsimore rajonale dhe drejtoritë e shkollave marrin masa për njoftimin e maturantëve/kandidatëve për datat, mjedisin dhe orën kur do zhvillohen provimet e sesionit të dytë.

14. Drejtori i DAR-së, brenda datës 4 shtator 2012, njofton zyrtarisht AKP-në për mjedisin ku do të zhvillohen provimet e sesionit të dytë.

15. Në DAR-të ku rezulton se numri i maturantëve/kandidatëve është më i madh se 500, mund të përdoren 2 mjedise.

16. Administrimi dhe zhvillimi i provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2012 të bazohet në rregulloren "Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2012 në Republikën e Shqipërisë", nr. 33, datë 6.1.2012.

KREU IV
HARTIMI DHE VLERËSIMI I TESTEVE TË PROVIMEVE TË SESIONIT TË DYTË TË MATURËS SHTETËRORE 2012

17. Procedurat e hartimit të testeve të provimeve të detyruara dhe me zgjedhje në sesionin e dytë, përcaktohen nga AKP-ja.

18. Pas zhvillimit të çdo provimi të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore 2012, testet e maturantëve/kandidatëve të dërgohen nën masa të rrepta sigurie në godinën e AKP-së.

19. Vlerësimi i testeve të këtij sesioni, të ndjekë procedurat e përcaktuara në rregulloren e Maturës Shtetërore 2012.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

20. Punonjësit që angazhohen jashtë kohës normale të punës në procesin e administrimit dhe të vlerësimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2012, të paguhen sipas akteve nënligjore në fuqi.

21. Shpenzimet e udhëtimit, të hotelit dhe ushqimit të specialistëve të përfshirë në këtë proces të mbulohen nga institucionet përkatëse.

22. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi: Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, AKP-ja, IKAP-i, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 12, datë 11.7.2012

PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT, TARIFËN E REGJISTRIMIT PËR KONKURRIM NË DISA PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PLOTË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, VITI AKADEMIK 2012-2013

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe në nenin 33 dhe 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi nr. 420, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të larët, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2012-2013", si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 8.2.2006 "Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Pranimet në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2012-2013, në:

1.1 Universitetin e Arteve të Tiranës (të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë);

1.2 Akademinë e Arteve Shkodër (të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë);

1.3 Universitetin e Sporteve të Tiranës (të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë);

1.4 Universitetin Politeknik të Tiranës (programet e integruara të studimit të ciklit të dytë "Arkitekturë" dhe "Arkitekturë-Urbanist");

1.5 Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër (programi i studimit të ciklit të parë me kohë të plotë "Edukim Fizik dhe Sporte");

1.6 Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan (programi i studimit të ciklit të parë me kohë të plotë "Edukim Fizik dhe Sporte");

1.7 Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës (programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën FASTIP), të bëhen mbi bazën e rezultateve të Maturës Shtetërore dhe të rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit, i organizuar nga këto Institucione Publike të Arsimit të Lartë.

2. Në Universitetin e Arteve të Tiranës dhe në Akademinë e Arteve në Shkodër, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 30% dhe rezultatet e konkursit të pranimit në masën 70%, sipas tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Konkurrimi për kandidatët e Akademisë së Arteve të Shkodrës do të kryhet në bashkëpunim me Universitetin e Arteve të Tiranës, në ambientet e këtij të fundit.

Kandidati që nuk kalon pragun e pikëve minimale të konkursit të pranimit, në programin ku ka konkurruar, sipas tabelës nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi, sipas përcaktimit për program studimi, nuk fiton të drejtën e studimit.

3. Në Universitetin e Sporteve të Tiranës rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 50%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 50%, sipas tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Në Universitetin Politeknik të Tiranës, në programet e studimit "Arkitekturë" dhe "Arkitekturë-Urbanist", rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 40% kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 60%, sipas tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

5. Në universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër dhe universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, në programin e studimit "Edukim Fizik dhe Sporte" rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 50%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 50%, sipas tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

6. Në programet e studimit të FASTIP të universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 40%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit (gjuha angleze dhe intervista e punësimit) në masën 60%, sipas tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

7. Për të gjitha programet e studimit, sipas pikës 1, të këtij udhëzimi, pikët minimale dhe maksimale të konkurseve përcaktohen në tabelën nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

8. Rregulloret dhe programet e konkurseve, të miratuara nga IAL Publike përkatëse, të bëhen publike, duke filluar nga data 1 gusht 2012.

9. Kandidatët që kanë kërkuar në formularin A2, programet e studimit sipas pikës 1, të këtij udhëzimi, si edhe kandidatët shqiptarë që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Lugina e Preshevës të regjistrohen për zhvillimin e konkursit pranë sekretarive mësimore të fakultetit përkatës. Periudha e regjistrimit të jetë nga data 16 gusht 2012 deri në orën 12:00 të datës 27 gusht 2012.

10. Agjencia Kombëtare e Provimeve AKP, deri në datën 14 gusht 2012, të përgatisë listën e konkurrentëve për konkurset e pranimit në programet e studimit sipas pikës 1, të këtij udhëzimi, sipas preferencës së kërkuar prej tyre në formularin A2.

11. Listat e konkurrentëve për secilin konkurs pranimi, të pikës 1, në formë të shkruar dhe elektronike, t'u dorëzohen institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas programit të studimit, në datën 15 gusht 2012 nga AKP për të gjithë kandidatët që kanë plotësuar formularin A2 dhe nga MASH-i për kandidatët shqiptarë që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Lugina e Preshevës.

12. Rektoratet dhe dekanatet e IAL-të Publike të shpallin në mjedise të dukshme të institucioneve të tyre deri në datën 10 gusht 2012: datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për të siguruar një ecuri normale të procesit të regjistrimeve në konkursin e pranimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë.

13. Sekretaritë mësimore të fakulteteve përkatëse, të programeve të studimit të pikës 1 dhe 2, pas verifikimit të listave të të regjistruarve, me listën e dorëzuar nga AKP dhe nga MASH, në datën 17 gusht 2012, ora 12:00 të shpallin listat e konkurrentëve të regjistruar dhe t'i afishojnë ato në vende të dukshme, në mjediset e fakulteteve të tyre.

14. Datat e konkursit të pranimit në këto institucione publike të arsimit të lartë, të jenë sipas këtij kalendari:

14.1 Universiteti i Arteve, Tiranë, për të gjitha programet e studimit në:

a) Fakultetin e Muzikës	27 gusht-1 shtator 2012;
b) Fakultetin e Artit Skenik	27 gusht-1 shtator 2012;
c) Fakultetin e Arteve Figurative	27 gusht-1 shtator 2012.

14.2 Universiteti i Sporteve të Tiranës, për programet e studimit:

a) Shkenca e lëvizjes	29-31 gusht 2012;
b) Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe të rekreacionit	29-31 gusht 2012.

14.3 Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, për programin e studimit:

a) Edukim Fizik dhe Sporte	27-29 gusht 2012.

14.4 Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan për programin e studimit:

a) Edukim Fizik dhe Sporte	27-29 gusht 2012.

14.5 Universiteti Politeknik i Tiranës, për programet e studimit:

a) Arkitekturë	3-5 shtator 2012;
b) Arkitekturë (Urbanist)	3-5 shtator 2012.

14.6 Universiteti "A. Moisiu" i Durrësit (FASTIP) për programet e studimit (programe në gjuhën angleze):

a) Menaxhim i bankave 27-29 gusht 2012;
b) Menaxhim Hoteleri Turizëm 27-29 gusht 2012;
c) Menaxhim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme 27-29 gusht 2012;
d) Multimedia dhe Teknologji Informacioni 27-29 gusht 2012.

14.7 Akademia e Arteve Shkodër, për të gjitha programet e studimit në:

a) Fakultetin e Muzikës 27 gusht-1 shtator 2012;
b) Fakultetin e Arteve Figurative 27 gusht-1 shtator 2012.

15. Tarifat e regjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkurset e pranimit në këto institucione publike të arsimit të lartë të jenë si më poshtë:

a) Në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës: 5,000 (pesë mijë) lekë.

b) Në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Arteve, Tiranë: 5,000 (pesë mijë) lekë;

c) Në programet e studimit në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër: "Edukim fizik dhe sporte", 5,000 (pesë mijë) lekë dhe "Pikturë-Grafikë", 5,000 (pesë mijë) lekë.

d) Në programin e studimit "Edukim Fizik dhe Sporte" në universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan: 4,000 (katër mijë) lekë;

e) Në programin e studimit "Arkitekturë" dhe "Arkitekturë-Urbanist" në Universitetin Politeknik të Tiranës: 8,000 (tetë mijë) lekë.

f) Në të gjitha programet e studimit në Akademinë e Arteve, Shkodër: 5,000 (pesë mijë) lekë.

16. Të gjitha tarifat e regjistrimit për konkurrim në programet e ndryshme të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë të arkëtohen nëpërmjet sistemit bankar ose zyrave të postës shqiptare, për llogari të IAL-së Publike përkatëse.

17. Konkurset e pranimit në këto institucione Publike të Arsimit të Lartë të monitorohen nga përfaqësues të MASH-it.

18. Rezultatet e konkurseve të pranimit të dërgohen në MASH e në AKP, në letër dhe CD, brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre. Për konkurrentët nga Republika e Kosovës, vetë IAL-të publike përkatëse, të shpallin kandidatët fitues, sipas kuotave të miratuara për çdo program studimi.

19. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimit Shkencor, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe Institucionet Publike përkatëse të Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS (TABELA NR. 1)
PËRQINDJET QË ZËNË MATURA SHTETËRORE DHE KONKURSI NË PIKËT FINALE TË MERITË-PREFERENËS

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	EMRTIMI I FAKULTETIT	ID_PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	% Maturës Shtetërore	% Konkursit të Pranimit
Univ. Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	074	Arkitekturë (Arkitekt)	40	60
Univ. Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	075	Arkitekturë (Urbanist)	40	60
Univ "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave te Edukimit	141	Edukim Fizik dhe Sporte	50	50
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	181	Edukim Fizik dhe Sporte	50	50
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	264	Menaxhim i Bankave (Program në Gjuhë Angleze)	40	60
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	265	Menaxhim Hoteleri Turizëm (Program në Gjuhë Angleze)	40	60
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	266	Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Program në Gjuhë Angleze)	40	60
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	267	Multimedia dhe Teknologji Informacioni (Program në Gjuhë Angleze)	40	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	268	Regji Filmi dhe TV	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	269	Aktrim	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	270	Regji	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	271	Skenografi - Kostumografi	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	272	Koreografi	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteit i Artit Figurativ	273	Pikturë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteit i Artit Figurativ	274	Skulpturë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	275	Muzikologji	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	276	Kompozim	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	277	Dirizhim	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	278	Piano	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	279	Violinë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	280	Violonçel	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	281	Violë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	282	Kitarë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	283	Kontrabas	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	284	Flaut	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	285	Oboe	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	286	Klarinetë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	287	Fagot	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	288	Korno	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	289	Trombë	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	290	Tromboné	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	291	Bastub	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	292	Kanto	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	293	Pedagogji Muzikore	30	70
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	294	Fizarmonikë Klasike	30	70
Univ. i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	295	Shkencat e Lëvizjes	50	50
Univ. i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	296	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	50	50
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	297	Violinë	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	298	Piano	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	299	Kanto	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	300	Kompozim	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	301	Dirigjim	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	302	Pikturë	30	70
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	303	Pikturë - Grafikë	30	70

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS (TABELA NR. 2)
PIKËT MAKSIMALE DHE MINIMALE SIPAS PROGRAMEVE NË KONKURSET E PRANIMIT

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	EMRTIMI I FAKULTETIT	ID_PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Pikët Maksimale	Pikët Minimale
Univ. Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	074	Arkitekturë (Arkitekt)	70	0
Univ. Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	075	Arkitekturë (Urbanist)	70	0
Univ "A.Xhuvani" Elbasan	Fakulteti i Shkencave te Edukimit	141	Edukim Fizik dhe Sporte	70	0
Univ "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	181	Edukim Fizik dhe Sporte	70	0
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	264	Menaxhim i Bankave (Program në Gjuhë Angleze)	100	40
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	265	Menaxhim Hoteleri Turizëm (Program në Gjuhë Angleze)	100	40
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	266	Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Program në Gjuhë Angleze)	100	40
Univ. "A. Moisiu" Durrës	Fakulteti Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP)	267	Multimedia dhe Teknologji Informacioni (Program në Gjuhë Angleze)	100	40
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	268	Regji Filmi dhe TV	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	269	Aktrim	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	270	Regji	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	271	Skenografi - Kostumografi	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	272	Koreografi	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteit i Artit Figurativ	273	Pikturë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteit i Artit Figurativ	274	Skulpturë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	275	Muzikologji	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	276	Kompozim	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	277	Dirizhim	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	278	Piano	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	279	Violinë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	280	Violonçel	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	281	Violë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	282	Kitarë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	283	Kontrabas	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	284	Flaut	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	285	Oboe	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	286	Klarinetë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	287	Fagot	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	288	Korno	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	289	Trombë	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	290	Trombone	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	291	Bastub	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	292	Kanto	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	293	Pedagogji Muzikore	240	60
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	294	Fizarmonikë Klasike	240	60
Univ. i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	295	Shkencat e Lëvizjes	70	0
Univ. i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	296	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	70	0
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	297	Violinë	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	298	Piano	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	299	Kanto	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	300	Kompozim	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	301	Dirigjim	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	302	Pikturë	240	60
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	303	Pikturë - Grafikë	240	60

UDHËZIM
Nr. 12, datë 19.7.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 749, DATË 28.12.1999 "PËR TRANSPORTIN RRUGOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës; në zbatim të nenit 63 të kapitullit 5 të ligjit nr. 8303, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore"; të shkronjës "a" të pikës 9.7 dhe pikës 9.8 të kapitullit IX të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 21.8.1998 "Për rregullat e klasifikimit, emërtimin dhe transportimin rrugor të mallrave të rrezikshme", Ministri i Punëve Publike dhe transportit,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 749, datë 28.12.1999 "Për transportin e mallrave të rrezikshme", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si më poshtë:

"Mjetet me motor, rimorkiot, gjysmërimorkiot për transportin e disa mallrave të rrezikshme kalojnë kontrollin për gjendjen teknike që kryhet në DPSHTRR, sipas udhëzimit nr. 5, datë 28.3.1999 "Për ekzaminimin e mjeteve dhe procedurat për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR.".

2. Paragrafi i dytë i pikës 2 riformulohet si më poshtë:

"Certifikata mod. 013 që lëshohet nga Inspektorati Qendror Teknik (IQT), veç të tjerave përmban rezultatet e inspektimit fillestar ose inspektimit periodik, ose inspektimit të ndërmjetëm, ose kontrolleve të veçanta, siç përmendet në Standardin Europian SSHEN 12972:2007 dhe kontrollit të provës siç përmendet në pikën 5.9.3 të urdhëresës nr. 1, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave, për rastin e mjeteve-cisternë, cisternave të çmontueshme, cisternave të transferueshme etj.".

3. Pika 4 riformulohet si më poshtë:

"Kontrolli i mjetit konsiston në verifikimin e plotësimit të kushteve teknike për efekt të sigurisë në rrugë, siç përcaktohet në udhëzimin nr. 5, datë 28.3.2012. Kontrolli kryhet në përputhje me urdhëresën nr. 1, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave dhe pjesën 9 të ADR-së.".

4. Pika 8 riformulohet si më poshtë:

"Një kopje e certifikatës mod. 0.13 dorëzohet nga subjekti në organin kompetent të dhënies së licencës për ushtrimin e veprimtarisë, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor"."

5. Në pikën 9, togfjalëshi "sipas modelit 012 bashkëngjitur këtij udhëzimi" zëvendësohet "sipas modeleve nr. 213 dhe 214 të udhëzimit nr. 20, datë 10.10.2007 "Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor".

6. Modeli nr. 013 për cisternat, bashkëlidhur udhëzimit nr. 749, datë 28.12.1999, ndryshohet me modelin nr. 013, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

Model 013
Formati A4

ÇERTIFIKATE E INSPEKTIMIT TE ÇISTERNES AUTOMOBILISTIKE TE MALLRAVE TE RREZIKSHME

Nr. seria_____

Numri i certifikatës_____	Emri prodhuesit_____
Subjekti_____	Vendi_____
Adresa_____	Numri shasisë_____
Data dhe lloji inspektimit të fundit	Viti prodhimit_____
_____	Targa_____

Tipi dhe marka cisternës_____

Ndarjet	1	2	3	4	5	6	7	8	total	

Trashësia e kërkuar e korpusit	mm , matja aktuale	mm
Trashësia e kërkuar e fundeve	mm , matja aktuale	mm
Trashësia e kërkuar e ndarjeve	mm , matja aktuale	mm
Presioni i provës	bar	
Presioni maksimal i lejuar i punës	bar , Vakumi i lejuar deri	bar
Presioni i llogaritur min	bar , max	bar

Kontrolli dokumentave	O	Prova hermeticitetit	O
Inspektimi brendëshëm i cisternës	O	Prova e depresionit	O
Inspektimi i jashtëm i cisternës	O	Përcaktimi kapacitetit ujor	O
Prova e presionit hidraulik	O	Inspektimi shasisë dhe pajisjeve	
Verifikimi i pajisjeve të punës	O	të strukturës së cisternave të zmontuesh	O
Valvola e sigurisë e taruar në (pres.relativ)	bar (pres relativ)	Valvola depresionit e taruar në	bar

Inspektime dhe prova të tjera_____

Vërejtje / difekte të konsiderueshme :

Inspektimi fillestar	O	i pranueshëm	O	i papranueshëm	O		
Inspektimi periodik	O	i pranueshëm	O	i papranueshëm	O		
Inspektimi i ndërmjetëm	O	i pranueshëm	O	i papranueshëm	O		
Kontroll jashtë rradhe	O	i pranueshëm	O	i papranueshëm	O		
ADR	O						

Inspektimi i ardhëshëm i rradhës_____ vendi dhe data_____

Inspektimi periodik O Data, nënshkrimi dhe vula _____

Inspektimi i ndërmjetëm O _____

Inspektimi i kryer konformë S SH EN 12972

Cisterna e mësipërme autorizohet për transportin e mallrave të rrezikshëm të specifikuar në miratimin e saj Mund të transportohen gjithashtu lëndët e tjera të rrezikshme të mëposhtme pasi të jetë kryer një kontroll jashtë radhe konformë SSH EN 12972 , 4.5.7.

Numri OKB	Emri i lëndës (për cisterna të specializuara) ose grupi i lëndëve (për cisterna shumë produktesh)

URDHËR
Nr. 77, datë 17.7.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI KRITERET E PËRBASHKËTA PËR PËRCAKTIMIN E NJË LISTE TË BE-SË PËR TRANSPORTUESIT AJRORË, TË CILËVE U NDALOHET OPERIMI BRENDA BE-SË DHE ZPAE-SË, SI DHE MBI INFORMIMIN E PASAGJERËVE PËR IDENTITETIN E KËTYRE TRANSPORTUESVE AJRORË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një Zone të Përbashkët Europiane të Aviacionit",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Mbi kriteret e përbashkëta në përcaktimin e një liste të BE-së për transportuesit ajrorë, të cilëve u ndalohet operimi brenda BE-së dhe ZPAE-së, si dhe mbi informimin e pasagjerëve ajrorë për identitetin e këtyre transportuesve ajrorë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil, për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

RREGULLORE
MBI KRITERET E PËRBASHKËTA PËR PËRCAKTIMIN E NJË LISTE TË BE-SË NË LIDHJE ME TRANSPORTUESIT AJRORË, TË CILËVE U NDALOHET OPERIMI BRENDA BE-SË DHE ZPAE-SË, SI DHE MBI INFORMIMIN E PASAGJERËVE PËR IDENTITETIN E KËTYRE TRANSPORTUESVE AJRORË

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat për:
a) Krijimin dhe publikimin në Republikën e Shqipërisë të listës së BE-së, në bazë të kritereve të përbashkëta, të transportuesve ajrorë, të cilët, për arsye sigurie, janë subjekt i një ndalimoperimi në vendet e BE-së dhe vendet e ZPAE-së;
b) Për detyrimin e informimit të pasagjerëve mbi identitetin e transportuesve ajrorë që operojnë fluturimet në të cilat ata udhëtojnë.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje:

a) "Transportues ajror" do të thotë një sipërmarrje e transportit ajror me një licencë të vlefshme operimi ose një dokument të barasvlershëm;

b) "Kontratë transporti" nënkupton kontratën me qëllim, përfshirjen e shërbimeve të transportit ajror, ku transportimi është i përbërë nga dy ose më shumë fluturime, të operuara nga i njëjti transportues ajror ose një transportues ajror i ndryshëm;

c) "Kontraktues i transportit ajror" do të thotë një transportues, i cili përfundon një kontratë të transportit me një pasagjer ose, aty ku kontrata përmban një paketë, me operatorin turistik (Tour Operator).

Çdo shitës biletash do të vlerësohet si një kontraktues i transportit ajror;

d) "Shitës biletash" do të thotë një shitës i një bilete ajrore, i cili rregullon një kontratë transporti me një pasagjer ose për një fluturim për vete, pasagjerin ose si pjesë të një pakete, krahas një transportuesi ajror apo një operatori turistik;

e) "Transportues ajror operativ" do të thotë një transportues ajror i cili kryen ose ka për qëllim të kryejë një fluturim sipas një kontrate transporti me pasagjerët ose në emër të një personi tjetër, juridik ose fizik, duke pasur një kontratë transporti me atë pasagjer;

f) "Autorizim operimi ose leje teknike" do të thotë çdo akt ligjor ose administrativ i Republikës së Shqipërisë, apo një shteti anëtar i ZPEA-së, i cili jep të drejtën që një transportues ajror të mund të operojë shërbimet ajrore për dhe nga aeroportet e tij, apo që një transportues ajror të mund të operojë në hapësirën ajrore të tij ose që një transportues ajror mund të ushtrojë të drejtat e trafikut;

g) "Ndalim operimi" do të thotë refuzimi, pezullimi, revokimi ose kufizimi i autorizimit të operimit të një transportuesi ajror ose i lejes teknike për arsye të sigurisë, apo çdo masë e barasvlershme sigurie ajrore, në lidhje me një transportues ajror i cili nuk ka të drejta trafiku brenda BE-së e rrjedhimisht edhe në ZPEA, por që avioni i të cilit mund të operohet ndryshe brenda BE-së sipas një marrëveshjeje qiraje;

h) "Paketë" do të thotë kombinimi i parapërgatitur i jo më pak se dy elementeve të mëposhtme, e cila shitet ose ofrohet për t'u shitur me një çmim gjithëpërfshirës, me kusht që shërbimi të ofrohet për një periudhë më të gjatë se 24 orë ose të përfshijë një akomodim për një natë.

Elementet e nevojshme të "paketës" janë:

- transport;
- akomodim;
- shërbime të tjera turistike jondihmëse për transportin ose akomodimin dhe të rëndësishme për një pjesë të mirë të paketës;

i) "Rezervim" nënkupton faktin që pasagjeri ka një biletë ose një provë tjetër, e cila tregon se rezervimi është pranuar dhe regjistruar nga kontraktuesi i transportit ajror;

j) "Standarde thelbësore të sigurisë" do të thotë standardet ndërkombëtare të sigurisë të përfshira në Konventën e Çikagos dhe anekset e saj, dhe aty ku janë të zbatueshme dhe ato të përfshira në marrëveshjen shumëpalëshe për krijimin e ZPEA-së.

KAPITULLI II
LISTA E BASHKIMIT EUROPIAN

Neni 3
Hartimi i listës së BE-së

1. Me synimin për të përforcuar sigurinë ajrore, BE-ja ka hartuar listën e transportuesve ajrorë që janë subjekt i një ndalimoperimi në territorin e BE-së, e rrjedhimisht edhe ZPEA-së sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të zbatojë, brenda territorit të RSH-së, ndalimet e operimit të përfshira në listën e BE-së, në lidhje për transportuesit ajrorë që janë subjekt i këtyre ndalimeve.

2. Kriteret e përbashkëta të cilat përcaktojnë një ndalimoperim mbi një transportues ajror, bazuar në standardet thelbësore të sigurisë, janë paraqitur në aneksin I të kësaj rregulloreje (dhe në vijim do t'u referohemi si "kriteret e përbashkëta").

3. Me qëllim krijimin dhe përditësimin e listës së BE-së, RSH-ja, në zbatim të marrëveshjes shumëpalëshe, do t'u komunikojë strukturave të Komisionit Europian, identitetin e transportuesve ajrorë që janë subjekt i ndalimit të operimit në territorin e saj, së bashku me arsyet e këtij ndalimi dhe çdo informacion tjetër.

4. Brenda një muaji nga marrja e informacionit të komunikuar nga RSH-ja, Komisioni Europian, në bazë të kritereve të përbashkëta, do të vendosë për një ndalimoperim për transportuesit ajrorë në fjalë dhe do ta reflektojë në listën e BE-së, të transportuesve ajrorë për të cilët është vendosur një ndalimoperim, në përputhje me procedurat përkatëse.

Neni 4

Qëllimi i përditësimit të listës së BE-së

1. Lista e BE-së përditësohet me qëllim:

a) për të imponuar një ndalimoperim mbi një transportues ajror dhe përfshirjen e këtij transportuesi në listën e BE-së, në bazë të kritereve të përbashkëta;

b) për të hequr një transportues ajror nga lista e BE-së, nëse mangësia ose mangësitë që çuan në përfshirjen e transportuesit ajror në listën e BE-së janë ndrequr dhe nuk ka arsye tjetër, në bazë të kritereve të përcaktuara, për ta mbajtur këtë transportues ajror në listën e BE-së;

c) për të modifikuar kushtet e një ndalimoperimi të vendosura mbi një transportues ajror i cili është përfshirë në listën e BE-së.

2. Komisioni, me iniciativën e tij ose me kërkesë të çdo shteti anëtar të BE-së e rrjedhimisht edhe anëtar të ZPAE-së, vendos lidhur me përditësimin e listës së BE-së sa më shpejt që kjo është e kërkuar sipas paragrafit 1 dhe në bazë të kritereve të përbashkëta.

Komisioni Europian verifikon të paktën çdo tre muaj, nëse është e përshtatshme të përditësojë listën.

3. RSH-ja, vendet e ZPEA-së dhe EASA duhet t'i komunikojnë Komisionit të gjithë informacionin që mund të jetë i rëndësishëm për sa i takon përditësimit të listës së BE-së. Komisioni e shpërndan këtë informacion tek të gjithë vendet e anëtare dhe ato të ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe.

Neni 5

Masat e përkohshme për përditësimin e listës së prioritetit

1. Aty ku është e qartë se operimi i vazhdueshëm i një transportuesi ajror në Bashkimin Europian dhe ZPEA, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, ka të ngjarë të përbëjë një rrezik serioz për sigurinë dhe se ky rrezik nuk është zgjidhur në mënyrën e duhur sa u takon masave urgjente të ndërmarra nga shteti përkatës i ZPEA-së përgjegjës për regjistrimin ose për anën rregullatore të sigurisë ajrore, ashtu siç sqarohet në nenin 6 (1) të kësaj rregulloreje, komisioni përkohësisht mund të miratojë masat e referuara në neni 4 (1) "a" ose"c" të kësaj rregulloreje.

2. Në kohën më të shpejtë, dhe më së shumti brenda 10 ditëve pune, Komisioni do të vendosë për të konfirmuar, ndryshuar, revokuar ose të japë masën të cilën e ka miratuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 6
Masa të jashtëzakonshme

1. Në rast emergjence, kjo rregullore nuk do të përjashtojë Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar, nga reagimi ndaj një problemi të paparashikuar të sigurisë ajrore duke imponuar një ndalimoperim të menjëhershëm në territorin e vet, mbi bazë të kritereve të përbashkëta dhe situatën konkrete të cenimit të sigurisë ajrore.

2. Vendimi i Komisionit Europian për të mos përfshirë një transportues ajror në listën e BE-së në përputhje me procedurën referuar nenit 3 (3) ose 4 (2) të kësaj rregulloreje, nuk ndalon Autoritetin e Aviacionit Civil nga imponimi ose mbajtja nën ndalimoperim të një transportuesi ajror, për çdo problem të evidentuar të sigurisë ajrore, që në mënyrë specifike ndikon në sigurinë e aviacionit në territorin e RSH-së.

3. Në rastet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet menjëherë të informojë Komisionin, i cili do të njoftojë shtetet e tjera të BE-së dhe ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe. Në përputhje me kërkesat e paragrafit 1, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet pa vonesë të njoftojë Komisionin Europian në funksion të përditësimit të listës së BE-së, siç parashikohet në nenin 4 (2) të kësaj rregulloreje.

Neni 7
Të drejtat e mbrojtjes

Kur Komisioni Europian merr vendime, si ato të referuara në nenet 3 (4), 4 (2) dhe 5, transportuesit ajrorë në fjalë i jepet mundësia për t'u dëgjuar, duke marrë parasysh nevojën, në raste të tilla, për një procedurë urgjente.

Neni 8
Publikimi

1. Lista e BE-së dhe çdo modifikim gjendet në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masat e nevojshme për të lehtësuar aksesin e publikut në listën e BE-së, në përditësimin më të fundit, e rekomanduar në veçanti nëpërmjet përdorimit të internetit.

3. Kontraktuesit e transportit ajror, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe operatorët aeroportualë në territorin e RSH-së, duhet të sjellin në vëmendje të udhëtarëve listën e BE-së, nëpërmjet faqes të tyre të internetit dhe përkatësisht edhe në zyrat e tyre.

KAPITULLI III
INFORMACIONI PËR UDHËTARËT

Neni 9
Qëllimi

1. Dispozitat e këtij kapitulli do të aplikohen në lidhje me transportin ajror të udhëtarëve, ku fluturimi është pjesë e një kontrate transporti mes palëve (udhëtari dhe transportuesi ajror) dhe ky transport ka filluar në territorin e RSH-së në rastet kur:

a) Fluturimi niset nga një aeroport në territorin e RSH-së në të cilin zbatohet kontrata;

b) Fluturimi niset nga një aeroport në një vend të huaj, joanëtar të ZPEA-së dhe arrin në një aeroport në territorin e RSH-së;

c) Fluturimi niset nga një aeroport në një vend të huaj, joanëtar të ZPEA-së dhe arrin në një aeroport të një vendi të huaj, joanëtar të ZPEA-së.

2. Dispozitat e këtij kapitulli do të zbatohen edhe nëse fluturimi është i planifikuar ose i paskeduluar (charter) dhe nëse fluturimi është pjesë e një pakete turistike ose jo.

3. Dispozitat e këtij kapitulli nuk do të ndikojnë në të drejtat e pasagjerëve, sipas parashikimeve të legjislacionit kombëtar.

Neni 10

Informacion mbi identitetin e transportuesit ajror në operim

1. Pas rezervimit, kontraktuesi i transportit ajror (transportuesi ajror), do të informojë pasagjerët mbi identitetin e transportuesit/transportuesve ajror/ë që operojnë, pavarësisht mjetit të përdorur për të bërë rezervimin.

2. Kur identiteti i transportuesit/transportuesve ajror/ë që operojnë nuk dihet akoma në kohën e rezervimit, kontraktuesi i transportuesit ajror duhet të sigurojë që pasagjerët janë informuar për emrin/emrat e transportuesit/transportuesve ajror/ë që është ose ka të ngjarë të operojë si transportues ajror në fluturimin/fluturimet në fjalë.

Në këtë rast, kontraktuesi i transportit ajror do të sigurojë që pasagjeri është informuar për identitetin e transportuesit/transportuesve ajror/ë operues sa më shpejt që identiteti i tij të jetë bërë i njohur.

3. Në rastin kur transportuesi/transportuesit ajror operues janë ndryshuar pas rezervimit, kontraktuesi i transportit ajror duhet, pavarësisht arsyes së ndryshimit, të marrë menjëherë të gjithë hapat e përshtatshëm për të siguruar që pasagjeri të informohet mbi ndryshimin sa më shpejt të jetë e mundur. Në të gjitha rastet, pasagjerët do të informohen në *check-in* ose gjatë imbarkimit në rastin kur nuk është e nevojshme një *check-in* për një fluturim lidhës.

4. Transportuesi ajror ose operatori turistik, sipas rastit, do të sigurojë që kontraktuesi i transportit ajror përkatës është informuar mbi identitetin e transportuesit ajror operues në momentin që kjo është bërë e ditur, në veçanti në rast të ndryshimit të një identiteti të tillë.

5. Nëse një shitës i biletave nuk është informuar për identitetin e transportuesit ajror operues, ai nuk do të jetë përgjegjës për mospërmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë nen.

6. Detyrimi i kontraktuesit të transportit ajror për të informuar pasagjerët për identitetin e transportuesit ajror operues duhet të specifikohet në kushtet e përgjithshme të shitjes, të zbatueshme për kontratën e transportit.

Neni 11

E drejta për rimbursim ose për riudhëtim (ridërgim në destinacion)

1. Kjo rregullore nuk do të ndikojë të drejtën për rimbursim ose drejtim të ri për në destinacionin final (re-routing) siç parashikohet në udhëzimin e ministrit "Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës së gjatë të fluturimeve" në fuqi.

2. Në rast kur udhëzimi i ministrit "Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës së gjatë të fluturimeve" nuk zbatohet; dhe

a) transportuesi ajror operues, që i është njoftuar pasagjerëve është përfshirë në listën e BE-së dhe është subjekt i një ndalimoperimi, gjë e cila ka çuar në anulimin e fluturimit në fjalë, ose që do të kishte çuar në një anulim të tillë nëse fluturimi do të operohej në BE apo shtet të ZPEA-së; ose

b) transportuesi ajror operues që i është njoftuar pasagjerëve, zëvendësohet nga një tjetër transportues ajror operues që është pjesë e listës së BE-së dhe është subjekt i një ndalimoperimi dhe kjo arsye ka çuar në anulimin e fluturimit në fjalë ose që do të kishte çuar në një anulim të tillë në qoftë se fluturimi në fjalë do të ishte operuar në aeroportet e BE-së, apo shtetet e ZPEA-së,

atëherë kontraktuesi i transportit ajror, i cili është palë në kontratën e transportit, do t'u ofrojë pasagjerëve të drejtën për rimbursim ose ridrejtim (re-routing) të parashikuar në artikullin 8 të udhëzimit të ministrit "Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës së gjatë të fluturimeve", me kusht që, aty ku fluturimi nuk është anuluar, pasagjeri ka zgjedhur të mos e marrë atë fluturim.

3. Paragrafi 2 i këtij neni do të zbatohet pa paragjykuar nenin 13 të udhëzimit të ministrit "Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës së gjatë të fluturimeve".

Neni 12
Sanksionet

Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të sigurojë pajtueshmërinë me rregullat e parashtruara në këtë kapitull dhe do të marrë masa ndëshkuese për shkeljen e këtyre rregullave. Dënimet duhet të jenë efektive, proporcionale dhe bindëse.

ANEKSI I

Kriteret e përbashkëta për vendosjen e një ndalimoperimi për arsye sigurie në nivelin Europian, rrjedhimisht duke përfshirë edhe vendet e ZPAE-së.

Vendimi për veprim në nivelin europian rrjedhimisht duke përfshirë edhe vendet e ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, ndërmerret në përputhje me çdo rast konkret.

Në varësi të kushteve specifike të çdo rasti, një transportues ose të gjithë transportuesit e certifikuar në të njëjtën gjendje mund të jenë subjekt për veprim në nivel europian.

Gjatë shqyrtimit nëse një transportues ajror duhet të ndalohet pjesërisht ose plotësisht, do të vlerësohet nëse transportuesi ajror i përmbush standardet thelbësore të sigurisë ajrore duke marrë parasysh sa më poshtë:

1. Evidencë të verifikuar të mangësive serioze të sigurisë nga ana e një transportuesi ajror:

- Raportet që tregojnë mangësi serioze të sigurisë ose paaftësi të vazhdueshme nga transportuesit ajrorë për të adresuar mangësitë e identifikuara nga inspektimet e kryera nën programin SAFA të komunikuara më parë transportuesit.

- Mangësi serioze të sigurisë ajrore të identifikuara në kuadrin e dispozitave ligjore për mbledhjen e informacionit, të përcaktuara në urdhrin e ministrit nr. 56, datë 2.5.2011.

- Ndalesa operative e vendosur mbi një transportues nga një vend i huaj, joanëtar i ZPEA-së, për shkak të mangësive të provuara në lidhje me mosrespektimin e standardeve ndërkombëtare të sigurisë.

- Informacionet lidhur me aksidentet e ndodhura ose informacionet e ndryshme lidhur me incidentet serioze që tregojnë mangësi sistematike të sigurisë ajrore të transportuesit.

2. Mungesa e aftësisë dhe/ose gatishmërisë së një transportuesi ajror për të adresuar mangësitë e sigurisë siç tregohet më poshtë:

- Mungesa e transparencës apo e komunikimit të duhur e të domosdoshëm dhe në kohë nga ana e një transportuesi në përgjigje të një hetimi nga ana e autoritetit të aviacionit civil të RSH-së në lidhje me aspekte të sigurisë ajrore e të funksionimit të saj;

- Plani i veprimeve korrigjuese jo i përshtatshëm ose jo i mjaftueshëm, i paraqitur në përgjigje të një ose më shumë mangësish serioze të identifikuara për sigurinë ajrore.

3. Mungesa e aftësisë dhe/ose gatishmërisë së autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e një transportuesi ajror për të adresuar mangësitë e sigurisë siç tregohet edhe nga:

- Mungesa e bashkëpunimit nga autoritetet kompetente të një shteti të regjistrit të mjeteve ajrore të transportuesit ajror, me Autoritetin e Aviacionit Civil të RSH-së, kur ka shqetësime për sigurinë ajrore të operimit të një transportuesi të licencuar ose certifikuar në atë shtet, ku ka dalë problemi në fjalë.

- Aftësinë e pamjaftueshme të autoriteteve kompetente të shtetit të regjistrit për mbikëqyrjen rregullative të transportuesit për të implementuar dhe zbatuar standardet përkatëse të sigurisë ajrore. Vëmendja e veçantë duhet përqendruar në:

a) auditimet dhe planet vepruese korrigjuese të hartuara sipas programit të inspektimeve dhe mbikëqyrjes së sigurisë ajrore;

b) nëse autorizimi i operimit ose leja teknike e çdo transportuesi i cili është nën mbikëqyrjen e një shteti dhe më parë ka qenë refuzuar ose revokuar nga një shtet tjetër;

c) certifikata e operatorit ajror nuk është lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit ku transportuesi ka vendin e vet të regjistrimit të biznesit;

d) aftësia e pamjaftueshme për mbikëqyrjen, në përputhje me detyrimet e Konventës së Çikagos, nga ana e autoriteteve kompetente të një shteti në të cilin avioni i përdorur nga transportuesi ajror është i regjistruar (shteti i regjistrit).

URDHËR
Nr. 287, datë 6.7.2012

PËR MIRATIMIN E FORMËS SË STUDIMIT, ME KOHË TË PJESSHME TË PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" DHE TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 24 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin në universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës, të formës së studimit me kohë të pjesshme, të programeve të studimeve të ciklit të parë "Bachelor" në:

a) Administrim biznesi;

b) Menaxhim turizmi;

c) Drejtësi.

2. Miratimin në universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës, të formës së studimit me kohë të pjesshme, të programit të studimeve të ciklit të dytë "Master profesional" në "Administrimin publik".

3. Programet e studimeve të ciklit të parë "Bachelor" dhe programi i studimeve të ciklit të dytë "Master profesional", me kohë të pjesshme, të pikës 1 dhe 2 të këtij urdhri, të fillojnë në vitin akademik 2012-2013.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 9.8.2012
Doli nga shtypi më 10.8.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë